

Takim online mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së dhe Drejtueses së Misionit të FMN-së për Shqipërinë

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–maj 2021
- Tregtimi i Titujve në Bursën ALSE, janar–qershor 2021

Zhvillime të tjera

- Bordi i AMF-së takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit për hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”
- Nis zbatimi i projektit të ri të Bankës Botërore për tregjet e kapitalit
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së merr pjesë në takimin me Dhomën Amerikane të Tregtisë për tregun e kapitaleve dhe listimin në bursë
- AMF nxjerr për konsultim publik rregulloret:
 - ✓ “Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021”
 - ✓ “Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore e furnizuese”
 - ✓ “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”
 - ✓ “Për llogaritjen e Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, të ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të Fondit të Kompensimit”
 - ✓ “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”

Edukimi Financiar

Studentët e disa fakulteteve të ekonomisë në Shqipëri, për herë të parë pjesëmarrës në konkursin ndërkombëtar “Bursa virtuale e titujve - të mësojmë rreth tregut të titujve”

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Hungari
- Qipro
- Maqedoni e Veriut
- Republika Çeke
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Takim online mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së dhe Drejtueses së Misionit të FMN-së për Shqipërinë

Z. Mete u shpreh se miratimi së fundmi nga Kuvendi i Ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", si edhe ligjet e tjera të miratuara vitin e kaluar "Për tregjet e kapitalit" dhe "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" përafrojnë kuadrin ligjor me direktivat evropiane.



9 qershor 2021 - Z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë takimit online me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë

Në datë 9 qershor 2021 u zhvillua një takim *online* mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete dhe Drejtueses së misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë, znj. Yan Sun.

Në takim u diskutua mbi ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit, efektet e pandemisë përgjatë vitit të kaluar, si edhe treguesit kryesorë financiarë. Z. Mete theksoi se tregjet financiare jobankare përgjithësisht u rezistuan efekteve të pandemisë, ndërsa treguesit e muajve të parë të vitit 2021 sugjerojnë rikthimin në normalitet, duke shënuar rritje të të ardhurave dhe aseteve neto.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv e informoi Drejtuesen e misionit të FMN-së për Shqipërinë në lidhje me veprimtarinë e Autoritetit në drejtim të plotësimit të kuadrin ligjor e rregullator për tregjet nën mbikëqyrje. Z. Mete u shpreh se miratimi së fundmi nga Kuvendi i Ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", si edhe ligjet e tjera të miratuara vitin e kaluar "Për tregjet e kapitalit" dhe "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" përafrojnë kuadrin ligjor me direktivat evropiane.

Drejtuesja e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar znj. Yan Sun vlerësoi rolin dhe masat rregullatore të ndërmarra nga Autoriteti përgjatë vitit pandemik, në funksion të garantimit të stabilitetit financiar dhe ruajtjes së treguesve financiarë të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-maj 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-maj 2021 kapën vlerën 7,009 milionë lekë, ose 15.51% më shumë se në periudhën janar-maj 2020. Gjatë periudhës janar-maj 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 361,233 me një rritje prej 1.86% krahasuar me periudhën janar-maj 2020.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.95 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.04%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 43.44% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 56.56% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-maj 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,144 milionë lekë, ose 7.98% më pak se në periudhën janar-maj 2020, kryesisht për shkak të pagesës së pjesës më të madhe të dëmeve të tërmeteve vitin e kaluar. Gjatë periudhës janar-maj 2021, dëmet e paguara bruto-sigurimi motorik kapën vlerën 1,714 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 51.42%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë periudhës janar-maj 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 1,714 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 51.42%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-maj 2021



Tregtimi i titujve në Bursën ALSE, 6-mujori i parë 2021

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë 6-mujorit të 2021, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 10,315,344 lekë dhe Obligacione Thesari në vlerën prej 318,983,690 lekë. Duke analizuar volumin për njësi të tregtuara, numrin e transaksioneve dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij 6-mujori, kanë dominuar transaksionet *off-exchange*.

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për 6-mujorin e 2021, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në volum, vlerë dhe numër, transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R. Sh. në Bursën ALSE Janar–Qershor 2021

Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (Në lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
për Anëtarët	0	51,068,050
për Klientët	10,315,344	267,915,640
Individë	10,315,344	99,156,140
Persona Juridikë	0	168,759,500
TOTAL	10,315,344	318,983,690

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 në Bursën ALSE kanë dominuar transaksionet e kryera për llogari të klientëve.

ZHVILLIME TË TJERA

Bordi i AMF-së, takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit, për hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”



15 qershor 2021 - Takimi me drejtuesit e shoqërive të sigurimit

Autoriteti është angazhuar në hartimin e një sërë rregulloresh, në zbatim të Ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më 15 qershor 2021, një takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit. Në takim u diskutua në lidhje me risitë dhe detyrimet që sjell ligji i ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si edhe për ecurinë e tregut të sigurimeve pas vitit pandemik.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete u kërkoi drejtuesve të shoqërive të sigurimit marrjen e të gjitha masave të nevojshme për zbatimin e plotë dhe pa vonesa të ndryshimeve ligjore.

Z. Mete kërkoi hartimin e procedurave të brendshme për trajtimin e shpejtë të kërkesave për dëmshpërbim në rastet e Raportit Evropian të Aksidenteve, pajisjen e të gjithë personave të siguruar me këtë formular, si edhe informimin e qytetarëve në lidhje me kushtet e reja të kontratës së sigurimit të detyrueshëm TPL bazuar në ndryshimet ligjore.

Në zbatim të ligjit të ri, që hyn në fuqi më 1 korrik 2021, Autoriteti është angazhuar në hartimin e një sërë rregulloresh, të cilat përpara miratimit po i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Në këtë kuadër, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vuri theksin te zhvillimi i një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në funksion të miratimit të akteve nënligjore jo vetëm cilësore, por edhe tërësisht të zbatueshme.

Treguesit e muajve të parë të vitit 2021 sugjerojnë rikthimin në normalitet të tregut të sigurimeve, i cili në nivel primesh të shkruara bruto, por edhe dëmsh të paguara ka përmirësim të ndjeshëm, krahasuar edhe me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Në takim, Bordi u kërkoi shoqërive të sigurimit ruajtjen e një qasjeje konservatore dhe vëmendje të shtuar në treguesit e aftësisë paguese dhe mbulimit me provigjone.

Nis zbatimin e projektit të ri të Bankës Botërore për tregjet e kapitalit



11 qershor 2021 - Takimi online i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së me Përfaqësuesin e Përhershëm të Bankës Botërore në Shqipëri

Projekti SECO II do të shërbejë për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, fuqizimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, si dhe ndërmarrjen e nismave për zhvillimin e tregut të kapitaleve përmes rritjes së edukimit financiar.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvilloi një takim online me Përfaqësuesin e ri të Përhershëm të Bankës Botërore në Shqipëri, z. Emanuel Salinas dhe znj. Maryam Salim, e cila përfundon mandatin e saj 4-vjeçar si Menaxhere e Bankës Botërore në vendin tonë. Në takim ishin të pranishëm edhe zv/Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, z. Patrik Meier, si edhe përfaqësues të tjerë të Bankës Botërore dhe Ambasadës Zvicerane.

Takimi u zhvillua në nisje të zbatimit të projektit të asistencës teknike të financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore për “Forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së për tregjet e kapitalit”.

Projekti do të shërbejë për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, fuqizimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, si dhe ndërmarrjen e nismave për zhvillimin e tregut të kapitaleve përmes rritjes së edukimit financiar.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv falenderoi Bankën Botërore për mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar rolin thelbësor që ajo ka luajtur ndër vite në rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe përmirësimin e kuadrit rregullator të Autoritetit.

Pjesëmarrësit në takim evidentuan progresin e bërë nga Autoriteti në drejtim të forcimit të rolit rregullator dhe mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së merr pjesë në takim me Dhomën Amerikane të Tregtisë për tregun e kapitaleve dhe listimin në bursë



2 qershor 2021 - Takimi online i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së me përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë

Z. Mete theksoi se përmes miratimit të dy ligjeve “Për tregjet e kapitalit” dhe “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” është krijuar kuadri i nevojshëm ligjor, i cili shërben si parakusht për mbështetjen e zhvillimit të tregut të kapitaleve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete mori pjesë në takim online të organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë “Tregu i kapitaleve dhe listimi në Bursën Shqiptare si një alternativë financimi për korporatat”. Në fjalën e mbajtur, Z. Mete theksoi se ky takim vjen në momentin më të përshtatshëm kur është plotësuar kuadri ligjor, por edhe infrastruktura e nevojshme për të mundësuar funksionalitetin e plotë të tregut të kapitaleve.

“Përmes miratimit të dy ligjeve “Për tregjet e kapitalit” dhe “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” është krijuar kuadri i nevojshëm ligjor, i cili shërben si parakusht për mbështetjen e zhvillimit të tregut të kapitaleve. Ligjet e reja diversifikojnë instrumentat dhe mundësitë e investimit në tregjet e kapitalit, si edhe shtojnë kërkesat për transparencë, në mënyrë që sistemi të ofrojë besim. Autoriteti mbetet i angazhuar në plotësimin e të gjithë kuadrit nënligjor e rregullator, në zbatim të ligjeve të reja, ku po asistohet edhe nga ekspertiza e Bankës Botërore,” – theksoi Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv

Z. Mete vuri në dukje se krahas infrastrukturës ligjore është plotësuar edhe infrastruktura e pastregtimit, nëpërmjet licencimit të Regjistrit Shqiptar të Titujve ALREG, i cili ka marrë gjithashtu funksionet e një Depozitari Qendror. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së nënvizoi se zhvillimi i tregut të kapitaleve kërkon angazhimin dhe bashkëveprimin e disa institucioneve me rol kyç në këtë treg. Në këtë kuadër, Autoriteti po bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në hartimin e një dokumenti strategjik për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vlerësoi nismën e Dhomës Amerikane të Tregtisë për ndërmarrjen e aktiviteteve të tilla informuese, por edhe sensibilizuese për bizneset, ndërsa theksoi angazhimin e Autoritetit në ndërmarrjen e hapave në funksion të edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve për tregjet e kapitalit dhe alternativat e investimit.

AMF nxjerr për konsultim publik rregulloret

AMF - Legjislacioni - Stabiliteti Financiar - Mbrojtja e Konsumatorit - Edukimi Financiar - Regjistri i të Licencuarve - Programi i Transparencës - Publikime

Projektregullore

Faqe Kryesore > Legjislacioni > Projektakte > Projektregullore

Projektregullore "Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore e furnizuese"

Projektregullore "Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021"

Projektregullore "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitareve"

Projektregullore "Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e Sipërmarrjeve të Licencuara të Investimeve Kolektive me Ofertë Publike"

VERIFIKONI POLICËN TUAJ

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
Rruga "Dora Dristra", Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri

Projektregulloret gjenden në:

- ✓ <https://amf.gov.al/pr-ojekt.asp?id=66>
- ✓ <https://amf.gov.al/pr-ojekt.asp?id=67>

1. "Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" ka hartuar projektregulloren "Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021". Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=66>

Kjo projektregullore përcakton rregullat e administrimit dhe pagesave të praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit, me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Të gjitha kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.

Ndërsa, kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti pas 1 korrikut 2021 trajtohen, paguhen dhe rimbursohen sipas dispozitave të Ligjit nr. 32/2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

2. "Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore e furnizuese"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", ka hartuar projektregulloren "Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore e furnizuese".

Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=67>

3. “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar projektregulloren “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=68>

Kjo projektregullore përcakton rolin mbikëqyrës, përmbajtjen, afatet, kërkesat për raportim dhe miratim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

4. “Për llogaritjen e Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, të ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të Fondit të Kompensimit”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar projektregulloren “Për llogaritjen e Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, të ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të Fondit të Kompensimit”. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=69>

Kjo projektregullore përcakton mënyrën e llogaritjes së Fondit të Kompensimit, kontributin e çdo anëtarit në vlerën minimale të Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, ndërhyrjes dhe afatet e rivendosjes së kësaj vlere.

5. “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar projektregulloren “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=70>


Objekt i kësaj projektregulloreje është përcaktimi i procedurave për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin elektronik të të dhënave të dëmeve sipas parashikimeve të neneve 41 dhe 43 të Ligjit nr. 32/2021, në Regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Kjo projektregullore ka për qëllim të sigurojë funksionimin efektiv, të drejtë dhe të bazuar në ligj, të regjistrit elektronik të dëmeve të Byrosë.

Projektrregulloret gjenden në:

- ✓ <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=68>
- ✓ <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=69>
- ✓ <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=70>

EDUKIMI FINANCIAR


Studentët shqiptarë nga fakultetet e ekonomisë, të universiteteve publike e private në vend, për herë të parë pjesëmarrës në konkursin ndërkombëtar “Bursa virtuale e titujve - Të mësojmë rreth tregut të Titujve”



Në dhjetor 2021, një juri e pavarur ndërkombëtare do të vlerësojë performancën e portofolave virtuale të investimeve për secilën skuadër dhe do të shpallë skuadrën fituese, e vlerësuar me çmim ndërkombëtar.

Në 24 qershor 2021, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE, Shoqata e tregtimit të Titujve në Shqipëri ASTA, me mbështetjen e German Sparkassenstiftung Albania (DSIK Albania) organizuan trajnimin online me studentët pjesëmarrës në konkursin ndërkombëtar “Bursa virtuale e titujve - Të mësojmë rreth tregut të Letrave me Vlerë”. Në këtë trajnim morën pjesë rreth 150 studentë, të ndarë në 50 skuadra, që përfaqësonin 15 fakultete ekonomike nga universitetet publike e private në vend. Ky aktivitet i parapriu pjesëmarrjes në konkursin ndërkombëtar, i cili do të fillojë në muajin shtator 2021 dhe do të zgjasë rreth 6 javë. Në këtë konkurs, skuadrat pjesëmarrëse do të kenë mundësinë e hyrjes në një ambient virtual, në formën e një platforme të centralizuar të internetit, e cila do ti pajisë me fonde virtuale, rreth 50,000 euro dhe do t’u japë mundësinë të investojnë në portofole të titujve me çmime reale të tregtimit të tyre në tregje financiare (aksione, obligacione, fonde investimesh, etj.) me qëllim maksimizimin e normës së kthimit nga investimi.

Në dhjetor 2021, një juri e pavarur ndërkombëtare do të vlerësojë performancën e portofolave virtuale të investimeve për secilën skuadër dhe do të shpallë skuadrën fituese, duke e vlerësuar me një çmim ndërkombëtar. Për herë të parë studentët shqiptarë bëhen pjesë e këtij konkursi, i cili ka si objektiv kryesor rritjen e edukimit financiar tek të rinjtë, për tregje pak të njohura siç janë bursa dhe tregu i kapitaleve.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e ka si një ndër objektivat e tij kryesore rritjen e edukimit financiar të publikut dhe sidomos të të rinjve. AMF ka filluar punën për përgatitjen e një strategjie për edukimin financiar për tregjet nën mbikëqyrje.

Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoe Ekzekutive e AMF-së duke përgëzuar organizatorët dhe të rinjtë pjesëmarrës në këtë trajnim, vlerësoi dëshirën e studentëve për të thelluar më tej njohuritë e marra nga studimet universitare për tregjet e kapitalit. Ajo theksoi se ky është një moment i përshtatshëm për të njohur më shumë për tregjet e kapitalit. Në vitin 2020 u miratua një paketë e re legjislative ku përfshihet ligji "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë" dhe "Për Tregjet e Kapitalit".

AMF, theksoi znj. Kaçi, po vijon punën për plotësimin e bazës rregullative duke krijuar kështu mundësinë për zhvillime të reja në tregjet financiare jobankare në vend.

Duke u uruar suksese studentëve dhe ekipeve pjesëmarrëse theksoi besimin se studentët, që po përfshihen gradualisht në tregun virtual financiar sot, do të jenë nesër investitorët në tregjet financiare.

* * *

Drejtori Ekzekutiv i Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE z. Artan Gjergji duke shpjeguar etapat që do të ndjekë i gjithë ky organizim theksoi se studentët do të prezantohen dhe luajnë realisht në bursë, ku të gjitha çmimet e kuotimet janë ato reale, siç përcaktohen çdo ditë në bursat ndërkombëtare, edhe për investitorët e vërtetë, vetëm shuma e parave që studentët do të marrin është virtuale. Kjo do t'u krijojë studentëve mundësinë për ta bërë sa më të qartë dhe saktë konkurrimin për investimet në bursë. Më pas z. Gjergji prezantoi detajet teknike duke i trajnuar studentët se si bëhet hedhja e urdhrave në platformë dhe tregtimi i titujve. Ai shpjegoi lidhur me:

- Platformat Elektronike të Tregtimit të Titujve;
- Paneli dhe Ekranet e Platformës që përdoret nga Broker/Investitori;
- Futja e Urdhrave për Blerje/Shitje të Titujve;
- Përcaktimi i karakteristikave të Urdhrave për Blerje/Shitje të Titujve;
- Llojet e Urdhrave dhe karakteristikat e tyre;
- Çfarë duhet të kenë kujdes investitorët.




Përmbajtja

1. Përmbajtja & procedurat
2. Si...?
3. "Për t'u bërë" në afat shkurtër

Presidenti i Shoqatës së Tregtimit të Titujve në Shqipëri, ASTA, z. Blodin Çuçi duke ju drejtuar studentëve theksoi se me simulimin e këtij konkursi ndërkombëtar rriten njohuritë e studentëve edhe si këshilltarë të ardhshëm në investime. Ne si organizatorë, shtoi ai, dëshirojmë të adresojmë nevojat për avancim në karrierën tuaj duke ju hapur mundësi të cilat më vonë ju vetë mund t'i shfrytëzoni.

Z. Çuçi prezantoi më pas rrugët për krijimin e një portofoli investimesh në tituj dhe menaxhimin e aseteve, duke i trajnuar studentët lidhur me:

- Çfarë është portofoli i Letrave me Vlerë/Titujve;
- Parimet e Bazë të krijimit të një Portofoli Titujsh;
- Llojet e letrave me Vlerë/Titujve që mund të përfshini në Portofol;
- Strategjitë e Investimit dhe përzgjedhja e Titujve sipas Riskut, Industrisë, Indikatorëve;
- Performanca e Portofolit dhe strategjitë e Diversifikimit dhe Mbrojtjes.



Edhe përfaqësuesi i DSIK Albania, z. Kliton Vaso përgëzoi studentët dhe pedagogët pjesëmarrës në këtë konkurs ndërkombëtar dhe shprehu mbështetjen e kësaj organizate për edukimin financiar të publikut dhe sidomos të të rinjve. Ai theksoi se DSIK Albania është e angazhuar për ofrimin e një çmimi të veçantë kombëtar (në Shqipëri), i cili do të shpërblejë skuadrën e studentëve shqiptarë me performancën më të lartë të investimit.

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave më të fundit të tregut të publikuara nga AZO BiH - Agjencia e Sigurimeve të Bosnje dhe Hercegovinës, vëllimi i primeve të shkruara bruto në fund të tremujorit të parë të vitit 2021 arriti në vlerën totale prej 192 milionë BAM (monedha lokale) ose rreth 98.2 milionë euro.

Siguruesit në Federatën e Bosnje-Hercegovinës siguruan rreth 70.5% të totalit të primeve të shkruara bruto, rreth 69.3 milionë EUR, ndërsa pjesa tjetër, 28.9 milionë EUR ishte pjesa e tregut të siguruesve në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës.

Në tërësi në treg, sigurimet e Jo-Jetës zinin rreth 79% të vëllimit total të primeve, rreth 77.6 milionë EUR, ndërsa sigurimi i Jetës kishin pjesën tjetër prej 20.64 milionë EUR.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave për tremujorin e parë të vitit 2021 të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, në fund të marsit 2021, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktivë 22 sigurues: 5 sigurues të specializuar në sigurimin e Jetës, 9 sigurues në sigurimet e Jo-Jetës dhe 8 sigurues të përbërë.

Vëllimi total i primeve të shkruara bruto, i raportuar nga siguruesit hungarezë, në fund të marsit 2021 arriti në 360.30 miliardë HUF, ose rreth 990 milionë EUR. Kjo shifër është mbi 7% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Në raport me vëllimin e primeve të shkruara bruto, sigurimet e Jetës zinin 42% dhe sigurimet e Jo-Jetës 58% të totalit të primeve. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 10% duke arritur në 149.97 miliardë HUF (412 milionë EUR), ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 5% duke arritur në 210.33 miliardë HUF (578 milionë EUR).

Në fund të tremujorit të parë 2021, numri total i kontratave të kompanive të sigurimeve mbeti përgjithësisht i pandryshuar, duke u rritur me 0.2% nga niveli i tij i këtij tremujori një vit më parë. Rritja erdhi kryesisht nga rritja prej 0.5% e kontratave të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa kishte rënie prej 0.9% të numrit të kontratave të sigurimit të Jetës.

Përsa i takon dëmeve të paguara, pagesat e dëmeve të shkaktuara për policat e sigurimit të Jetës u ulën me 0.7%, ndërsa i njëjti tregues për sigurimin e Jo-Jetës arriti në 50.83 miliardë HUF, ose 17.62% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Në fund të marsit 2021, tregu maqedonas i sigurimeve arriti në 2.68 miliardë Dinarë (monedha lokale) ose rreth 43.6 milionë euro. Sipas të dhënave paraprake të siguruar nga Agjencia lokale e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, rritja e vëllimit të primeve të shkruara bruto ka qenë 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Rritja më e madhe u vërejt në Sigurimin e Jo-Jetës, i cili u rrit me pothuajse 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një vit më parë, duke arritur vlerën e 2.27 miliardë Dinarë. Sigurimet e Jo-Jetës zënë rreth 84.6% të primeve të shkruara bruto në total. Në këtë segment të tregut pjesën më të madhe e zënë sigurimi MTPL me 995 milion Dinarë dhe sigurimi i pronës me 584 milionë Dinarë.

Sigurimi i Jetës arriti një vëllim të primeve rreth 414.5 milionë Dinarë, ose 0.5% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të tregut për vitin 2020, të botuara në faqen online të IAC - shoqata lokale profesionale e siguresve, industria e sigurimeve arriti një vëllim primesh prej 917 milionë EUR.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës pësoi një ulje prej -0.7%, duke arritur në 507 milionë EUR, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës pati rritje me 7.5% duke arritur një vëllim të primeve të shkruara bruto në 410 milionë EUR.

REPUBLIKA ÇEKE

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të raportuara nga Shoqata Çeke e Sigurimeve, CAP, për tremujorin e parë 2021, tregu vendor i sigurimeve arriti në 37.68 miliardë CZK ose rreth 1.44 miliardë EUR. Tregu lokal i sigurimeve u rrit me 2.4% në tremujorin e parë 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo shpreh një ngadalësim të ndjeshëm të shkallës së rritjes me një vit më parë, kur rritja ishte 6% për të njëjtën periudhë.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës gjatë tremujorit të parë 2021 u rritën me 1.8%, duke arritur në 11.93 miliardë CZK, ose 456.4 milionë EUR, ndërkohë që në të njëjtën periudhë të një viti më parë rritja e primeve ishte 2.7%. Edhe numri i policave të reja të sigurimit vijoi rënien, duke u ulur me rreth 5.9% në këtë periudhë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Edhe në sigurimet e Jo-Jetës, shkalla e rritjes u ngadalësua. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 25.75 miliardë CZK, ose rreth 985 milionë EUR, e cila tregon një rritje prej 2.7% në tremujorin e parë 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo tendencë u pasqyrua në të gjitha degët e monitoruara me përjashtim të sigurimit të pronës, ku u arritën rezultate më të mira se viti i kaluar.

Sigurimi motorik mbizotëroi në treg, por rritja e tij është ngadalësuar që nga fillimi i vitit. Sigurimi i automjeteve vazhdon të jetë mbizotërues, duke zënë më shumë se 50% të totalit të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, vëllimi i primeve të shkruara bruto të gjeneruara nga tregu i sigurimeve në Turqi, në fund të marsit 2021, arriti në 25.3 miliardë TRY (monedha lokale) ose rreth 2.6 miliardë EUR. Kjo shifër shënon një rritje prej 15.8% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Sigurimet e Jo-Jetës siguruan 21.4 miliardë TRY prime, ndërsa sigurimet e Jetës arritën në 3.8 miliardë TRY. Gjithashtu, në fund të marsit 2021, siguruesi shtetëror rriti fitimin e tij neto me 3%, duke arritur në 329 milionë TRY, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shoqëria e sigurimeve “*Turkey Insurance*” e cila e ka filluar funksionimin e saj prej datës 7 shtator 2020, do të bashkojë gjashtë kompani shtetërore të sigurimeve dhe pensione.

Krijimi i ndërmarrjes më të madhe të sigurimeve dhe pensione në vend ishte një projekt i Ministrisë së Thesarit dhe Financave në mënyrë që të rrisë normën e kursimeve të brendshme të vendit dhe sektorin e shërbimeve financiare jobankare.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al